

SIVANTO PRIME

PRODUKT PËR MBROJTJEN E BIMËVE



“Lexo fletëudhëzuesin para përdorimit”

SIVANTO PRIME është insekticid sistemik me spektër të gjerë veprimi që i përket klasës së re kimike të butenolideve. Ka veprim kontakti dhe të brendshëm. Falë mekanizmit të tij të ri të veprimit, përdorimi i tij është një mjet i dobishëm për të kufizuar zhvillimin e popullatave rezistente të dëmtuesve.

Lënda vepruese: *Flupyradifurone 200 g/lit;*

Formulimi: *Koncentrat i tretshëm (SL);*

Ngjyra: *E verdhë në kafe.*

Masat parambrojtëse:

- Ruhet larg mundësisë për tu arritur nga fëmijët, larg kontaktit me ushqimet e njerëzve, ujin dhe ushqimin e kafshëve.
- P280: Vishni dorashka mbrojtëse/rroba mbrojtëse/mbrojtëse për fytyrën/sytë.
- EUH401: Për te shmangur risqet ndaj shëndetit njerëzor dhe mjedisit, zbatoni udhëzimet për përdorimin.
- Gjatë punës mos hani dhe mos pini lëngje e duhan.
- P501: Asgjeroni kontenierin sipas rregullave në fuqi.

Udhëzime për ndihmën e parë dhe këshilla për mjekun:

H332: E dëmshme nëse thithet. P304+P340: *Nëse thithet:* Lëvizeni të dëmtuarin në ajër të freskët dhe mbajeni në prehje në një pozicion komod për frymëmarrje. Telefono menjëherë mjekun.

H317: Mund të shkaktojë një reaksion alergjik lëkure. *Nëse bije në kontakt me lëkurën:* Lajuni tërësisht me ujë të bollshëm dhe sapun, nëse keni, me polyethyleneglycol 400, duke vazhduar shpëlarjen me ujë. Nëse simptomat vazhdojnë, kërko ndihmë mjekësore

H319: Shkakton irritim të rëndë syri. *Nëse bije në kontakt me sytë:* Shpëlajni menjëherë me ujë të bollshëm, gjithashtu nën qepalla, për të paktën 15 minuta. Hiq, nëse ke i ke vendosur, lentet e kontaktit. Nëse shqetësimi vazhdon pas 5 minutave të para, vazhdo të shpëlajsh sytë. Kërko ndihmë mjekësore nëse irritimi shtohet dhe vazhdon.

Nëse gëlltitet: MOS shkakto të vjella. Kërko ndihmë mjekësore. Mbaje të dëmtuarin të qetë dhe në ambient të ngrohtë. Në rast gëlltitje të sasive të mëdha (më shumë se një gojë plot) këshillohet përdorimi i karbonit aktiv dhe sulfatit të natriumit.

H373: Mund të shkaktojë dëme në organe (muskuj) nëpërmjet ekspozimit të tejkzgjatur ose të përsëritur.

P308+311: Në qoftë se ekspozoheni ose shqetësoheni: Telefononi një qendër mjekësore ose mjek.

Antidot specifik nuk njihet. Trajtimi simptomatik.

Përdorimi:

Në mollë dhe dardhë: kundër morrave gri përdoret para lulëzimit (stadi i balonit), me 60-75 ml/100 lit ujë (0.6-0.9 lit/ha). Kundër morrave të gjelbër përdoret pas lulëzimit, në fillim të infektimit, me 60-75 ml/100 lit ujë (0.6-0.9 lit/ha). Përdoret 1 herë/sezon.

Në hardhi (rrush për tavolinë dhe verë): kundër cikadeve (*Scaphoideus titanus*, *Metcalfa pruinosa*), përdoret me 60 ml/100 lit ujë (0,5 lit/ha). Kundër *Empoasca vitis* (= *flavescens*) përdoret me 40 ml/100 lit ujë (0.3 lit/ha), Përdoret 1 herë/sezon, duke filluar nga faza para lulëzimit.

Domate, spec, tranguj, patëllxhan (në fushë të hapur): kundër afideve përdoret në fillim të infeksionit me 60-75 ml/100 lit ujë (0,45-0,56 lit/ha). Kryeni 1 trajtim/sezon.

Domate, spec, tranguj, patëllxhan (në serë): kundër afideve përdoret në fillim të infeksionit me 60-75 ml/100 lit uje (0.45-1.125 lit/ha). Kundër krahebardhave përdoret me 75 ml/hl (0.56-1.125 lit/ha). Përdoret maksimumi 2

herë/sezon, me interval 10 dite.

Kungull, shalqi (në fushë te hapur): kundër afideve përdoret në fillim të infeksionit me 60-75 ml/100 lit ujë (0,45-0,56 lit/ha). Kryeni 1 trajtim/vit.

Kungull, shalqi (në serë): kundër afideve, në fillim të infeksionit, me 60-75 ml/100 lit uje (0.45-1.125 lit/ha). Kundër krahebardhave përdoret me 75 ml/hl (0.56 lit/ha). Përdoret maksimumi 2 herë/sezon, me interval 10 dite.

Marule (mbjellje në fushë të hapur): kundër afideve, trajtohet në fillim të infeksionit, nga fillimi i formimi të kokës, me 75 ml/100 lit ujë (0.625 lit/ha). Kryeni një trajtim/sezon.

Lule shtrydhe (në serë): kundër afideve trajtohet në fillimin e infektimit me 60 ml/100 lit ujë (0,5 lit/ha); kundër krahë bardhave përdoret në fillim të infektimit me 75 ml/100 lit ujë (0.625 lit/ha). Përdoret maksimumi 2 herë/sezon, me interval 10 dite.

Mjedër, manaferra (në sera): kundër afideve, përdoret në fillim të infektimit me 100 ml/100 lit ujë (1 lit/ha). Përdoret maksimumi 2 herë/sezon, me interval 10 dite.

Në duhan: kundër afideve (*Myzus persicae*, *Myzus nicotianae*) përdoret në fillim të infektimit me dozë 60 ml/100 lit ujë (0,5 lit/ha). Kryhet 1 trajtimi/sezon.

Bimë zbukuruese dhe per lule (në serë): kundër afideve, përdoret në fillim të infektimit me 50-60 ml/100 lit ujë (0,5 lit/ha). Kryeni 1 trajtim/sezon. Kundër krahë bardhave, përdoret në fillim të infektimit me 75 ml/100 lit ujë (0.75 lit/ha). Përdoret maksimumi 4 herë/sezon, me interval 7 dite.

Në fidanishtet e eterovajore e pyjeve, pemëve frutore (në sera): kundër afideve, përdoret në fillim të infektimit me dozë 60-75 ml/100 lit ujë (0,6-0,75 lit/ha). Kundër krahë bardhave, përdoret në fillim të infektimit me dozë 75 ml/100 lit ujë (0.75 lit/ha). Përdoret maksimumi 4 herë/sezon, me interval 7 dite.

Vërejtje për përdorimin:

Të përdoret doza e rekomanduar për ha, pavarësisht sasisë së ujit të përdorur.

Fitotoksiciteti:

Te perimet dhe bimët zbukuruese, këshillohet që të kryhen teste paraprake të fitotoksicitetit në disa bimë përpara se të trajtoni. Përdorimi në disa lloje trangulli mund të shkaktojë shenja fitotoksiciteti.

Ndikimi në ekosistem:

H410: Shumë toksike për jetën ujore me efekte afatgjata. Mos ndotni ujjat dhe burimet ujore që rrjedhin në lumenj e rezervuarë uji. SP1: Mos e ndotni ujin me produktin ose ambalazhin e tij (mos pastroni pajisjet e aplikimit pranë ujit sipërfaqësor/shmangni ndotjen përmes kanalizimeve nga kopshtet dhe rrugët). Spe3: Për të mbrojtur organizmat ujor respektoni një zonë të ndërmjetme 20 m të pa spërkatur për masivet ujorë sipërfaqësorë. P391: Mblidheni atë që derdhet. Mesatarisht helmues për gjitarët, zogjtë dhe për bletët.

Karenca:

Mollë dhe hardhi 14 ditë; sallatë, lule shtrydhe, patëllxhan, domate, spec, trangull, kungull dhe shalqin 3 ditë.

Ruajtja dhe magazinimi:

Ruhet në vende të thata, të ajrosura, larg rrezeve direkte të diellit, në temperaturë 0-40° C.

Nr dhe data e regjistrimit:

Sasia neto e PMB-se, që ndodhet në ambalazhin bazë: deri 1 lit.

Data e prodhimit: *Printuar nga makineria në ambalazh;*

Data e skadencës ose periudha e ruajtjes (sipas kërkesave të përcaktuara): 4 vite;

Numri i partisë së mallit (serisë) ose shenja të tjera identifikuese: *Printuar nga makineria në ambalazh;*

Tipi i ambalazhit bazë: shishe COEX ose HDPE.

Emri dhe adresa e Aplikantit: Bayer doo. **Adresa:** Ljubljane, Slloveni.

Fabrikuesi i PMB-së: Bayer AG. **Adresa:** Leverkusen, Gjermani.